



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 04, datë 24.12.2024

**PËR**  
**MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN:**  
**“STRUKTURË ME FUNKSION HOTELERI ME 1-4 KATE MBI TOKË DHE 1 KAT**  
**NËNTOKË”, ME VENDNDODHJE NË LIVADH, BASHKIA HIMARË**

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28, të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të subjekteve zhvilluese shoqërive “Rina 04” sh.p.k dhe “Devis Construction” sh.p.k., Këshilli Kombëtar i Territorit,

**VENDOSI:**

1. Miratimin me kusht të Lejes së Ndërtimit për objektin: “Strukturë me funksion hoteleri me 1-4 kate mbi tokë dhe 1 kat nëntokë”, me vendndodhje në Livadh, Bashkia Himarë, me subjekte zhvilluese shoqëritë “Rinia 04” sh.p.k. dhe “Devis Construction” sh.p.k.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave dhe Dokumenti i Rregullores së Veçantë i bashkëlidhen këtij vendimi si pjesë përbërëse e tij.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas:
  - a) plotësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor;
  - b) pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Himarë.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit dhe Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi, pasi nënshkruhet nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit, hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

DIKAMA

KRYETARI

KRYETARI

KRYETARI

KRYETARI

KRYETARI

KRYETARI

KRYETARI

MINISTËR I LINJËS  
MINISTËR I TURIZMIT, KULTURËS DHE SPORTIT  
BLENDI GONXHJA



ANËTAR/SEKRETAR I KKTU  
DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT E TERRITORIT

ADELAJDA ROKA



Nënshkruar më datë 02/02 2026